



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 46, Datë 27.02.2025

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 221, DATË 23.10.2024,
“MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBESP TRADING & CONSULTING” SH.P.K.
PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË
KONTROLLON INTERESAT E SAJ”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.02.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1026/2 prot., datë 25.02.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 221, datë 23.10.2024, mbi kërkesën e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 221, datë 23.10.2024 ka vendosur dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. me kushtin që brenda datës 31.12.2024 të depozitojë marrëveshjen/kontratën për shitjen e kuotave dhe ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i ndryshimit të ortakut që kontrollon interesat e saj.
- ERE me shkresat me nr. 1628/9 prot., datë 15.11.2024, nr. 1628/10 prot., datë 05.12.2024, dhe me e-mailin nr.1026 prot., datë 07.02.2025 njoftoi dhe solli në vëmendje të shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. për detyrimet e saj lidhur me autorizimin e ndryshimit të ortakut për plotësimin e kushteve të vendimit.
- Shoqëria me shkresën nr.1064 prot., datë 10.02.2025, ka depozituar ekstraktin historik të regjistrit tregtar ku është reflektuar ndryshimi i ortakut që kontrollon interesat e saj. Gjithashtu me shkresën nr. 1026/1 prot., datë 13.02.2025, shoqëria ka depozituar

marrëveshjen/kontratën me nr. repertori. 3472 dhe nr. koleksioni 1447 të datës 09.05.2024, për shitjen e kuotave të shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. nga Z. Klodian Melëngu tek Znj. Eni Hasanbelliu e cila bëhet zotëruese me 51% të kapitalit të shoqërisë.

- Me depozitimin e dokumentacionit të sipërcituar, rezulton se shoqëria disponon marrëveshjen/kontratën për shitjen e kuotave si dhe ekstraktin historik të regjistrit tregtar në të cilën është reflektuar ndryshimi i ortakut që kontrollon interesat e saj. Si e tillë vlerësohet që pikat 4 dhe 5 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 221., datë 23.10.2024, të shfuqizohen. Me shfuqizimin e pikave 4 dhe 5 të vendimit nr. 221/2024, nuk gjen më zbatim as pika 6 e këtij vendimi ndaj vlerësohet dhe shfuqizimi i saj.
- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, i cili duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pikat 4, 5 dhe 6 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 221, datë 23.10.2024, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve, të njoftojë shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI